



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 Maj 2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit së Drejtorëve të mbajtura më 27 prill 2017 dhe mbledhjes urgjente me 12 maj 2017 të paraqitura për aprovim, nëpërmjet kësaj aprovohen si procesverbale të mbledhjeve të Bordit të cekura më lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/2

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-080), në bazë të nenit 6 të Rregullores për monitorim të NSH Trepça e datës 21 korrik 2016, në bazë të nenit 5.9 të Udhëzuesit për Lirim të Aseteve të NSH-ve dhe Shfrytëzuesëve të Paligjshëm dhe në bazë të Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurive të tyre Nr. 04/L-035, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet çmimi për qira i përcaktuar nga Komisioni i themeluar me vendimin nr. 161/2017, në vlerën prej € 90.00 për muaj kalendarik për sipërfaqen e tokës prej 895 m<sup>2</sup> të parcelës kadastrale P-72015063-00548-1, pronë e N.Sh. "Fabrika e Municionit të Gjuetisë" në Skenderaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/3

Në bazë të neneve 6.2 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080), si dhe bazuar në Rregullat e Procedurave të Shitjes dhe Rregullave të Përgjithshme të Tenderit të datës 21 shtator 2016, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim që do të publikohen për shitje si Shitje e Aseteve përmes Likuidimit 34, dhe me depozita të caktuara gjatë mbledhjes, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet Lista e asetëve për Shitjen e Asetëve me Likuidim 34 me depozitat sipas listës në Shtojcën 1.
- II. Lista me asetet e aprovuara për tenderim janë të bashkangjitura me këtë vendim si Shtojca 1.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/4

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-080), pas shqyrtimit të raporteve të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore Nr. 04/L-061, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohen Raportet e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 12 maj 2017.
- II. Lista me asetet e aprovuara për tenderim janë të bashkangjitura me këtë vendim si Shtojca 1.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-92/5

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-080), Rregullores për qiradhënie të aseteve të NSH-ve dhe kriterëve dhe metodologjisë së vlerësimit të qirasë të qiradhëniet direkte të datës 26 gusht 2016 e amendamentuar me 13 tetor 2016, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohen çmimet e qiradhënies sipas listës (të bashkangjitur) për asetet e trajtuara sipas Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në likuidim, nga uzurpatorët apo shfrytëzuesit e jashtëligjshëm.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/6

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080), dhe nenit 6.1 të marrëveshjes së zotimeve për Ndërmarrjen e Dubrava Livestock Dairy Farm, pas rekomandimit të Menaxhmentit të AKP-së sipas Raportit të Auditorit të Pavarur, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:


## V E N D I M

- I. Aprovohet lirimi nga kushtet e marrëveshjes për zotime sipas nenit 6.1. të Marrëveshjes për zotime për blerësin dhe Ndërmarrjen e re "Dubrava Livestock Dairy Farm".
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/7

Në bazë të neneve 15.1 dhe 6.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080), pas rekomandimit të Menaxhmentit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Të shitet përmes tenderit publik materiali i Ndërmarrjes së re MIM Golesh, i paraqitur në memorandumun nën pikën 6.7 të agjendës së mbledhjes së Bordit të datës 25 maj 2017, sikurse në vijim:
  - a) Shkëmbinj ultrabazik (material për mbushje) me granulacion – 60 mm, material i thërrmuar, sasia rreth 50000 t.
  - b) Zhavorr nga shkëmbinj të dunitit, me granulacion -5 +1mm, sasia rreth 1000m3 ose rreth 2000 t.
  - c) Koncentrati i magnezitit, granulacioni -10 +1mm. Sasia e materialit 524,168.0 t, si dhe
  - d) Sasia prej 41.083.16 ton të dunitit.
  
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/8

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080), nenit 41 (paragrafët 1, 2 dhe 4), dhe nenit 43 të Shtojcës së të njëjtit ligj, si dhe nenit 13 të Udhëzuesit të AKP-së për Likuidim, pas propozimit të Autoritetit të Likuidimit dhe Menaxhmentit, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohen raportet e shpërndarjes së përkohshme të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për Ndërmarrjet Shoqërore në shtojcë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/ 05 / 2017



Petrit Gashi

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/9

Në bazë të neneve 15.1 dhe 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-080), pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për rritje të buxhetit të likuidimit për Ndërmarrje Shoqërore në likuidim, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M


- I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për N.SH. GJI023 "Zarije Bujic" në likuidim që konsiderohet i domosdoshëm për mbarëvajtjen dhe përmbylljen e procesit të likuidimit;
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e vendimit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/10

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-080), pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet dhënia në shfrytëzim i barakës për nevojat NP "Termokos" pa kompensim deri në përcaktimin e saktë të kufijve të ngastrave kadastrale të NP "Termokos" dhe N.Sh "Auto Prishtina". Të shqyrtohen mundësitë e ndarjeve me njësinë për kadastrë në kuadër të AKP-së përmes Agjencisë Kadastrale të Kosovës.
  
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/11

Në bazë të neneve 6.1 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-080), pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:


## V E N D I M


- I. Shfuqizohet vendimi i Bordit të Drejtorëve Nr.Ref.BD-80/4 i datës 31 gusht 2016 lidhur me qiradhënien e asetit të NSH "Ereniku-Industria" me sipërfaqe prej 0.89.94 Ha në vendin e quajtur Piskotë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-92/12

Në bazë të nenit 15.1 dhe 31.4 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-080) dhe Shtojcës së tij, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:


## V E N D I M

- I. Anulohen të gjitha dhe çfarëdo veprime të Ndërmarrjes Shoqërore Përparimi, të ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe/apo të Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me të drejtat e pretenduara nga kompania Dajti ndaj pronës së NSH Përparimi për ndërtimin e hapësirës biznesore në parcelat e NSH Përparimi në Prishtinë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-92/13

Në bazë të neneve 6.2.2, 6.2.3, 9 dhe 15.2.13 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-080), dhe neneve 12 dhe 13 të Shtojcës së po të njëjtit ligj, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për futjen në likuidim të Ndërmarrjeve Shoqërore të caktuara, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 maj 2017 nxjerr këtë:

## V E N D I M


- I. Të iniciohet procedura e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore në datën e paraqitur në tabelën e mëposhtme, duke përfshirë edhe aprovimin e buxhetit të likuidimit të vlerësuar për Ndërmarrjen Shoqërore, ndërsa shpenzimet e buxhetit realizohen në bazë të vendimit të Bordit të datës 21 qershor 2012.

Vendimi për likuidim dhe fillimi i procedurave të likuidimit të hyjë në fuqi me datë 12 qershor 2017

Nr.	AKP Nr. ID	Emri i ndërmarrjes	Kategoria	Komuna	Regjioni
1	PRN111	Përparimi	NSH	Prishtinë	Prishtinë

- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të emëroj Autoritetin e Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e Vendimit të Bordit (përfshirë çfarëdo zëvendësimi të kohëpaskohshëm );
- III. Aprovohet shitja e të gjitha asetëve "Sipas ligjit dhe akteve nënligjore të AKP-së" të cilat janë të listuara në dokumentin "Përmbledhje për Bord" (Board Brief) për ndërmarrjen e propozuar për fillim të procedurave të likuidimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25/05/2017



Petrit Gashi

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit